

KOZ  
U PROTOKOLLUA  
NR 496 PROT  
DATE 6.5.21  
Raport Perfundimitar i Monitoruesve

Shtojca nr. 3

## I. Përmbledhie

<b>Vëzhguesi:</b> (Emri, mbiemri)	
<b>Rajoni/ Njësia administrative e monitoruar:</b>	Njësia Administrative Ana e Malit Njësia Administrative Dajç Njësia Administrative Postribë Njësia Administrative Velipojë Njësia Administrative Pult Njësia Administrative Shalë Njësia Administrative Shosh
<b>Subjektet Zgjedhore të monitoruar:</b>	Partia Socialiste (PS) Partia Demokratike (PD) Partia Social Demokrate (PSD) Lëvizja Socialiste për Integrim (LSI)
<b>Periudha e mbuluar nga raporti:</b>	15 Mars 2021 -03 Maj 2021
<b>Data e dorëzimit të raportit:</b>	03 Maj 2021
<b>Nënshkrimi</b>	

Shënim: për Seksionin II (monitorimi i aktiviteteve të fushatës), një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e dhënë. Për seksionin III (monitorimi i abuzimeve/ keqpërdorimeve të bürimeve shtetërore), një raport duhet të plotësohet për të gjithë zonën gjeografike të monitoruar.

## **II. Subjekti Zgjedhor – AKTIVITETET E MONITORUARA TË FUSHATËS**

Një raport monitorimi i veçantë duhet të plotësohet për secilin subjekt zgjedhor, duke përdorur formularin e mëposhtëm.

Raporti i Monitorimit për Subjektin Zgjedhor: **Partia Socialiste ; Partia Demokratike;Lëvizja Socialiste për Integrim ;Partia Social Demkrate ;Instirucione Publike (Shkolla,Qendra Shëndetësore ;Njësi Administrative ) ;Subjekte Private të Miratuara nga KQZ-ja (shtoni emrin e subjektit zgjedhor).**

### **1. Përmbledhja e aktiviteteve të monitoruara të subjektit zgjedhor**

<b>Lloji i aktivitetit të monitoruar</b>	<b>Detaje</b>
a) Zyrat Zgjedhore	Vendndodhja e zyrave zgjedhore të monitoruara Zyrat Vendore të subjekteve zgjedhore (Partia Socialiste ;Partia Demokratike; Lëvizja Socialiste për Integrim; Partia Social Demokrate. Selia Qëndrore e subjekteve zgjedhore me vendndodhje në Shkodër. Në njësinë Administrative Postribë kemi zyra zgjedhore të 3 (Tre) subjekteve zgjedhore ( PS;PS; PSD) .Në Njësinë Administrative Velipojë kemi zyra të 2 (dy) subjekteve zgjedhore (PD dhe LSI) . Në njësitë admimsitrative të tjera nuk kemi zyra fizike të ngritura të subjekteve zgjedhore.

b) Ngjarjet e Fushatës

Numri i plotë i ngjarjeve të monitoruara të fushatës të mbajtura nga E/s që CM monitoroi : (8 ngjarje )

c) Materialet  
propagandistike

Numri i plotë materialeve propagandistike të monitoruara (të bashkangjiten mostra/foto për secilen)

Materiale propogandistike të monitoruara më shumë se 10/referuar fotove të raporteve sipas grafikut të monitorimit .

Numri i plotë i materialeve vizive propagandistike të shqyrtuara për përfshirjen e shënimit: 'Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të ...'Numër +8

d) Monitorimi i Faqeve te internetit

Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara

Facebook ,Faqe website,Instagram të subjekteve zgjedhore dhe kandidatëve të partive politike.  
Faqe/platforma aktive,të aksesueshme dhe gjithëpërfshirëse ku secila nga subjektet zgjedhore /kandidatët e tyre ,paraqesin veprimtarinë e fushatës elektorale dhe aktivitetet ;takimet;me qytetarët,grupet e interesit ;në ambiente të hapura,me strukturat e partisë,grupet e punës.Shpaloset ,prezantimet e programeve politike .

## 2. Parregullsitë e vëzhguara

Neni	Parregullsia	Numri i parregullsive të raportuara në KQZ dhe datat e tyre
Neni 78, pika 6	Fushata zgjedhore në një institucion publik	Gjatë ushtrimit funksional të detyrës,monitoruesi nuk raportor shkelje apo parregullsi gjatë fushatës zgjedhore në institucion publike (institucion publike /njësi administrative,shkolla ,qendra shëndetësore ,lokale private të miratuara nag KQZ-ja . Duke konsideruar intervistat me punonjësit në njësitë administrative nën administrimin territorial të monitotuesit.

			Nuk kemi dyshime të arsyeshme ,që të ngrihen hipoteza të arsyeshme apo fakte konkrete për fushatë zgjedhore në institucione publike.
Neni 78, pika 7	Subjektet zgjedhore/kandidatëti ofrojnë ose japin para, të mira materiale, premtojnë vende pune ose favore të tjera, votuesve ose personave të tjerë që kanë lidhje me të, me qëllimin marrjen e nënshkrimit për emërimin e një kandidati për zgjedhje, për të votuar në një mënyrë të caktuar, për të marrë pjesë ose jo në votim, ose në këmbim të angazhimit në aktivitete jo ligjore për të mbështetur një kandidat ose një parti politike.		Nuk kemi raste të denoncuara apo deklaruar direkt apo indirekt nga qytetarët apo punonjësit publik(përfshirë drejtuesit e shkollave ) apo persona të tjerë ,që kanë lidhje me kandidatin Apo marrja e nënshkrimit ,angazhimi në aktivitete ligjore për mbështetur kandidat apo parti politike.
Neni 78, pika 9	Subjekti zgjedhor/Kandidati që organizon, bën ose mbulon shpenzimet për koncert, ngjarje kulturore dhe zbavitëse ose aktivitete bamirësie.		Nuk kemi raste të tilla lidhur me organizimet ,shpenzimet për koncerte ngjarje kulturore apo aktivitete zbavitëse me të ardhur personale.
Neni 78, pika 10	Subjekti zgjedhor/Kandidati që ofron sende ose materiale të printuara me vlerë prej më shumë se 5 (pesë) qind Lekë për send ose material.		Subjektet zgjedhore /kandidati nuk ka ofruar sende apo materiale me vlerë mbi 5 (pesë)lekë .Më qellime manipuluese ndaj elektoratit.
Neni 79, pika 2	Paraqitja e materialeve propagandistike statike më shumë se 5 metra nga zyra elektorale		Gjatë monitorimit në Njësitë Administrative subjektet zgjedhore /kandidatët e tyre kanë respektuar rrezen e distancës 5 m nga zyra të materialeve propogandistike (flamuj identifikues me të dhënat e tyre ,postera apo materiale të tjera statike me qëllim propagandistike (karta të kandidatëve apo fletëpalosje ).
Neni 3,paragrafi 2, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Materiale propagandistike të vendosura në fasadat e godinave të banimit, institucione publike ose ambiente rrethuese pranë e rreth tyre, brenda zonave rekreative,parqeve, në pemët e qytetit dhe në shtyllat e ndriçimit.		Monitoruesi në vëzhgim të drejtpërdrejt nuk vëren materiale propogandistike të vendosura në institucione ,ambiente publike,rrethuese ,pemë ,shtylla ndriçimi ,shenja konvencionale,tabela treguese. Zonat parqe kombëtare apo zo rekreative .apo godina banimi .Siç shihet në foto .
Neni 3, paragrafi	Materiale propagandistike të vendosura në mjete që operojnë në		Nuk kemi raste të vendosjes së materialeve propogandistike të

3, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	transportin publik.		vendosura në mjete që operojnë në transportin publik (autobus, fuoristrada, taxi, furgona dhe çdo mjet tjetër i destinuar për transport publik).
Neni 5, Udhëzim nr. 6 datë 23.03.2021, i KQZ-së	Zyrat Zgjedhore të subjekteve zgjedhore të vogël se 300 metra nga vendndodhja VNV-ve.	janë hapur në distancë më të madhe se 300 metra nga KZAZ-ve, QV-ve dhe VNV-të.	Zyrat zgjedhore të subjekteve kanë distancë më të madhe se 300 metra, por jo më të vogël se 300 metra nga KZAZ-të, QV-të dhe VNV-të. Konkretisht në të gjitha Qëndrat e Votimit të monitoruara, KZAZ-JA Nr. 02 në Shkodër, dhe VNV-të nuk kanë rreth tyre, as në distancë më të vogël se 300 metra zyra zgjedhore /subjekteve zgjedhore.
Neni 79, pika 3	Mos përfshirja e deklaratës së autorizimit në fushatës propagandistike	në materialet vizive të	<b>Neni 79</b> Afishimi I materialeve propagandistike (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020) Të gjitha materialet propagandistike vizive që përdoren në fushatë duhet të shoqërohen me shënimin: "Prodhuar nën përgjegjësinë ligjore të..." (vijon emri i subjektit zgjedhor). Monitoruesi nuk konstaton raste të mospërfshirjes së deklaratës së autorizimit në materialet audiovizive gjatë fushatës propagandistike.

### **I. Raport mbi monitorimin e abuzimeve ndaj burimeve shtetërore**

Ky raport monitorimi plotësohet për të gjithë zonën e monitoruar, duke përdorur formularin e mëposhtëm:

#### **1. Përmbledhje e Aktiviteteve të Monitoruara**

Lloji i aktivitetit të	Detaje

monitoruar	
a) Monitorimi i Faqeve te Internetit	Listë gjithëpërfshirëse e platformave të faqeve të internetit të monitoruara Facebook ,Faqe ëebsite;Instagram
b) Përdorimi i burimeve shtetërore	<p>Numri i plotë dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të nëpunësve të administratës gjatë orarit të punës.</p> <p>Monitoruar dhe indentifikuar ngjarje për përdorim të mundshëm të nëpunësve të adminsitratës gjatë orarit të punë ( numër 8)</p> <p>Numri i plotë dhe identifikimi i aktiviteteve/ngjarjeve të fushatës të monitoruara për përdorim të mundshëm të studentëve para-universitar brenda orarit të mësimit.</p> <p>Monitoruesi brenda orarit të mësimit është paraqitur në disa skolla të mesme ,fillore .9 vjeçare.( 20 totali )</p> <hr/> <p>Numri i plotë/Identifikimi i institucioneve publike mjediset e të cilëve u monitoruan për të parë nëse po përdreshin për aktivitete të fushatës.</p> <p>Shkolla;Ndëertesa /godinat administrative /qendra shëndetësore ( +20)</p> <p>Numri i plotë i vëzhgimeve të bëra për përdorimin e automjeteve publike të vëzhguara në ngjarjet e fushatës.(+8)</p> <p>Gjatë vëzhgimit direkt dhe intervistimit për përdorimin e automjeteve të transportit publik në ngjarjet e fushatës .(10 ngjarje ) Transporti publik nuk është përdorur për qëllime fushate .</p>
c) Aktivitete të natyrës	Numri i plotë i aktiviteteve të monitoruara të një natyre publike të cilat kërkojnë njoftimin/raportimin tek KQZ-ja.

publike

Nuk ka pasur aktivitete të tilla .Përveç, organizimeve në agjendë insitucionale apo trajnimet të nëpunëve. (5 ngjarje )

## 2. Abuzimi i burimeve shtetërore- Parregullsitë e vëzhguara

Neni	Parregullsia		Numri i plotë i parregullsive të vëzhguara dhe data në të cilën cdo parregullsi u raportua në KQZ
Neni 91, pika 2	Përdorimi i detyruar në fushatën zgjedhore të administratës së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore.		Nuk kemi raste të përdorimit të detyruar në fushatën zgjedhore të administratës së institucionit publik ,shkollave,qëndrave shëndetësore ,brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore/fushate . Drejtuesit e këtyre institucioneve publike deklarojnë me përgjegjësi të plotë ,gjatë gjithë periudhës para-gjatë -pas fushatë nuk kemi shpërdorim apo shfrytëzim të orarit të punës për qëllime fushate. Madje çdo mungesë e personelit gjatë orarit te punës është verifikuar dhe arsyetuar ligjërisht (raste leje 1orë për arsye vizi shëndetësore ,me raport nga mjeku i lagjes ose specialisti ).
Neni 91, pika 2	Përdorim i detyruar dhe organizuar brenda orarit të mësimi të studentëve të sistemit shkollor para-universitar në fushatën zgjedhore.		Orari i mësimi ka vijuar normalisht në dy sesione online dhe fizikisht sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit,Sportit dhe Rinisë. Parimisht dhe faktikisht është zbatuar në mënyrë taksative depolitizimi i shkollave. Institucione publike ,apolitil

			,të pavarura,të pandikuara ,sipas dispozitave në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë për Arsimin .
Neni 91, pika 2	Premtimi ose ofrimi i përfitimeve punonjësve, ose studentëve për të marrë pjesë në aktivitete që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ose shkollës ose të ushtruarit e presionit mbi to për këtë qëllim.		Në kuptim të këtij neni, “burime” quhen asetet e luajtshme dhe paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit. Me përdorim të “burimeve njerëzore” kuptohet përdorimi i detyruar në fushatë zgjedhore I administrates së institucionit brenda orarit të punës për qëllime zgjedhore, si dhe përdorimi i detyruar dhe organizuar brenda orarit mësimor nxënësve të sistemit shkollor parauniversitar në fushatë zgjedhore. Me përdorim të burimeve njerëzore kuptohet gjithashtu premtimi ose ofrimi i përfitimeve nëpunësve publikë, ose nxënësve për të marrë pjesë në veprimtari që lidhen me fushatën zgjedhore jashtë ora të punës ose mësim, si dhe ushtrimi i presionit ndaj tyre për kë qëllim. Monitoruesi nuk konstaton presione ,përfitime ,premtime të studentëve apo punonjësve për të marrë pjesë në aktivitete,që lidhen me fushatën jashtë orarit të punës ,dhe kundër vullnetit të tyre . Pasi çdo veprim i tillë konsiderohet shkelje flagrante e Kodit Zgjedhor dhe vesim vullneti për të ushtruar të drejtën e votës ,dhe bindjet e politike .
Neni 91, pika 3	Punësimi, pushimi nga puna, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucione ose ente publike gjatë fushatës zgjedhore, përveç rasteve të justifikuara.		3. Gjatë fushatës zgjedhore ndalohe marrja në punë, pushimi nga puna, lirimi, lëvizja dhe transferimi në detyrë në institucionet apo ente publike, me përjashtim të rasteve të përligjura. Konsiderohen raste të përligjura rastet kur lëvizja apo lirimi nga puna vjen si rrjedhojë e shkeljeve, sipas legjislacionit përkatës, ose marrja në punë bëhet brenda structures dhe organikës në fuqi përpara fushatës zgjedhore nga institucioni apo enti public në përmbushje të misionit të tij. Bëj



			përrjashtim rastet e emergjencave për shkak të ngjarjeve të paparashikuara që diktojnë marrjen në punë.Në monitorim të institucioneve publike ,shkollave ,qëndrave shëndetësore nuk kemi pasur lëvizje ,transferime,pushime nga puna ,përrshkak të fushatës elektorale, apo gjatë fushatës të diktuar nga subjekte zgjedhore .
Neni 92, pika 1, e 6	Mos raportimi i aktiviteteve të natyrës publike të kryer nga institucione publike vendore dhe qendrore, si dhe agjensi shtetërore dhe/ose ndërrmarrje.		<b>Neni 92</b> Veprimtaritë e institucioneve publike në fushatë (ndryshuar me ligjin nr. 101/2020, datë 23.7.2020) 1. Institucionet publike, qendrore dhe vendore, si dhe agjencitë dhe/ose ndërrmarrjet shtetërore, janë të detyruara të raportojnënë KQZ të gjitha veprimtaritë me Karakter public që planifikojnë të zhvillojnë në periudhën katër muaj para dates së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve. Formojnë veprimtari publike të gjitha veprimtaritë që janë të hapura për pjesërrmarrjen e publikut apo të medias, si dhe ato që kanë në agjendë informimin, në periudhën katër muaj para dates së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve, e publikut rreth ty Institucionet publike nuk kanë zhvilluar aktivitete të natyrës publike ,për të cilat nuk janë raportuar në KQZ.Në intervalin kohor katër muaj para datës së zgjedhjeve deri ditën e zgjedhjeve .
Neni 91, pika 5	Kryerja e aktiviteteve të ndaluara nga KQZ-ja.		Nuk kemi aktivitete të ndaluara nga KQZ-ja ,që i kanë shërbye fushatës zgjedhore,subjekteve zgjedhore apo çdo forme tjetër ,me qëllim manipulimin e vullnetit të zgjedhësve.